



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.549/23

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Agrounion sh.p.k, me nr. unik 810344573, me seli në fshatin Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.T., avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Financave – Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. Rexhep Krasniqi, lidhur me çështjen përmbarimore për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1024/21 të datës 02.11.2022, me datën 22.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Ministria e Financave – Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1024/21 i datës 02.11.2022, dhe Lënda kthehet te Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1024/21, të datës 02.11.2022, në pikën I të dispozitivit e ka Refuzuar prapësimin e debitorit Ministria e Financave – Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. Rexhep Krasniqi, për shkak të borxhit në shumën prej 1,279.00€, i paraqitur kundër urdhrit për përmbarim numër P.nr.452/21 i datës 08.06.2021 i caktuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe shkeljes të dispozitave të UA nr.MD-NR.06/2014, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit Dogana e Kosovës si e bazuar dhe të priset aktvendimi PPP.nr.1024/21 i datës 02.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë si i pabazuar.

Përgjigje në ankese ka parashtruar i autorizuari i kreditorit, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit, të parashtruar kundër aktvendimit PPP.nr.1024/2021, dhe të obligohet ushtruesi i ankesës/ debitori që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale për ankese në lartësi prej 624,00€.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigje në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e debitorit, është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbarimit "Agrounion" sh.p.k, me nr. unik 810344573, me seli në fshatin Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë Kosovë, me datën 06.08.2021, ka paraqitur propozimin për përmbarim për pagimin e borxhit, kundër debitorit Ministria e Financave – Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. Rexhep Krasniqi, në bazë të dokumentit përmbarues aktgjykimit të formës së prere A.nr.1366/2015, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar propozimi i kreditorit ashtu që të obligohet debitori që t'ia ktheje mjetet në shumë prej 1,279.00€, me kamatë ligjore prej 8% nga data 24.07.2015 e deri në përmbarimin e tërësishëm., si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin përmbarimor P.nr.452/21 i datës 08.06.2021, duke lejuar propozimin për përmbarim, kundër të cilit, debitori ka paraqitur prapësim me datën 17.06.2021, duke theksuar se debitori fare nuk është paraqit në Doganën e Kosovës për kthim të mjeteve por i është drejtuar me propozim përmbaruesit privat për qka ka shkaktuar shpenzime të panevojshme të procedurës përmbarimore, i propozon gjykatës që urdhrin përmbarimor ta hedhë poshtë si të pabazuar si dhe prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me propozimin që gjykata prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1024/21, të datës 02.11.2022, e ka Refuzuar prapësimin e debitorit Ministria e Financave – Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, rr. Rexhep Krasniqi, për shkak të borxhit në shumën prej 1,279.00€, i paraqitur kundër urdhrin për përmbarim numër P.nr.452/21 i datës 08.06.2021 i caktuar nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ A.nr.1366/15 i datës 12.09.2019 i plotfuqishëm nga data 19.03.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 07.06.2021, në bazë të cilit përmbaruesi privat ka caktuar përmbarimin, i cili është dokument përmbarues dhe përbën bazë juridikë për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore sipas dispozitave të nenit 21, 22 par.1 pika 1.1, 23, 24 dhe 27 të LPP-së për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale -Dhomat e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës, dhe me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, neni 183.1 i LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar drejt gjendjen faktike që ka rezultuar nga shkresat e lëndës, respektivisht nuk ka konstatuar faktin se debitori pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit A.nr.1366/2015 datës 12.09.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, ka ndërmarr veprimet ligjore në drejtim të ekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm, dhe kthimin e mjeteve, e konfirmuar nga Ministria e Financave me datën 09.07.2021 se janë realizuar mjetet në vlerë prej 1,886.19€ në llogari të debitorit.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar shkresat e lëndës për të vërtetuar se kreditori ka parashtruar kërkesë brenda afatit ligjor tek debitori për ekzekutimin e aktgjykimit të plotfuqishëm A.nr.1366/2015 dt.12.09.2019, nuk është provuar se debitori me veprimet e tij ka rënë në vones, në ekzekutimin e aktgjykimit, për të arsyetuar pretendimet e kreditorit i cili në këtë rast ka inicuar procedurën përmbartimore për mos përmbushje vullnetare (afati partitiv) të borxhit nga debitori, dhe nuk është e qartë nëse debitori ka pranuar në llogarinë bankare shumën prej 1,886.19€, sipas konfirmimit-Urdhërit-kthimin e mjeteve nga Ministria e Financave datë 09.07.2021, i cili transaksion bankar do të konfirmonte se debitorit i është bërë pagesa sipas aktgjykimit të plotfuqishëm.

Mos vërtetimi i provave kontestuese, si prova të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejte në nxjerrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, përbejnë shkelje të dispozitës së Nenit 183.1 të LPK-së, i cili përcakton: *se ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare*, prandaj është dashur që aktvendimi i goditur të anulohet dhe lënda ti kthehet Dhomës së shkallës së parë në rivendosje.

Në ri-procedurë, Dhomat e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të vlerësohen faktet vendimtare, se ka përfunduar apo jo kthimi i mjeteve kreditorit sipas aktgjykimit përmbartimor, ashtu që të sigurohet ligjshmëria e lejimit të propozimit për përmbartim i kreditorit, sa i përket kthimit të shumës prej 1,279.00€, kamata 8% duke llogaritur nga data 24 korrik 2015 e deri në përmbartimin e tërësishtë, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.549/23 datë 22.02.2024

Gj y q t a r i,
Krenar Berisha